



2324  
154/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

Nr. 1148/4 Prot.

Tiranë, më datë 30.10.2023

Lënda: Kthim përgjigje.

**QENDRA "RES PUBLICA"**

*Adresa: Blv. "Gjergj Fishta", Nd. 24, H. 3, Ap. 7, Tiranë*

Në vijim të shkresës tuaj, ku kërkonti kopje të Vendimit Nr. 451, datë 31.08.2022 të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, paraqitur nga ana juaj me Nr. 154/23 Prot., datë 23.10.2023 dhe administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me Nr. 1148/3 Prot., datë 24.10.2023, bashkëlidhur kësaj shkrese ju vendosim në dispozicion vendimin e sipërcituar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**Klesta QIRICI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1063 Prot.

Tiranë, më datë 31.08.2022

VENDIM  
Nr. 451, datë 31.08.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 "Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale", Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 "Për miratimin e rregulloreve për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saf", pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 31.08.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin në parim për "Sistemi i Furnizimit me Ujë të Himarës, Lidhja e Linjës Kryesore të Dërgimit me sistemin e furnizimit me ujë të fshatrave Pilur, Kudhës, Himarë Fshat dhe Vuno si dhe Rrjeti i brendshëm i Ujësjetës të këtyre fshatrave", me aplikues Genti Çupi dhe zhvillues Bashkia Himarë, duke kryer plotësimet e mëposhtme:
  - Plani i detajuar i ndërhyrjeve në lidhje me zonat e trashëgimisë kulturore në përputhje me komponentët e projektit;
  - Detajet teknike të thellësive dhe shtresave gjatë shtrimit të tubacioneve dhe montimit të pajisjeve matëse.
  - Të realizohet raporti i vëzhgimit arkeologjik i hapësirës së shtrirjes.
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislati për trashëgiminë kulturore, punimet të zbatohen dhe mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Rudina ZOTO

